



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 1 Mars 2023

Nr: 80

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS TË BASHKISË PËRMET, PËR
RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE TË DATË 14 MAJ 2023**

Sot më datë 1 Mars 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim çështjen administrative me:

SUBJEKT: Zj. Denisa Durro, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Përmet

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Përmet, për raportimin e veprimtarive publike

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 6.2.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka marrë indicie për organizimin e 1 (një) veprimtarie publike nga ana e bashkisë Përmet.

Indicia është marrë nëpërmjet provave ku pretendohet si në vijim:

Data: 1 Mars 2023

Nr: 80
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Përmet, për raportimin e veprimtarive publike”

“...Sot, përkujtuam së bashku me veteranë, pasardhës të tyre, familje të dëshmorëve si dhe përfaqësues të institucioneve vendore, 79-vjetorin e Brigadës “Heroinë e Popullit”.

Informacioni që KRIIK disponon lidhur me këtë veprimtari publike është vetëm link-u që po ju vëmë në dispozicion:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=485050707150258&set=pcb.485050960483566>

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, pasi shqyrtova paraprakisht çështjen, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Më datë 9.2.2023, bashkisë Përmet i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike

Më datë 9.2.2023, ora 2:18 PM, bashkia Përmet bën me dije se: *“Përsa i përket aktivitetit sipas email-it të dhënat janë si më poshtë:*

Data: 26.01.2023 **Ora:** 10.00

Organizatori: Shoqata e Veteranëve, Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve

Tematika e aktivitetit: Përkujtim i Brigadës së VI sulmuese

Pjës marrës: Anëtare të Shoqatës së Dëshmorëve, Anëtare të familjeve pasardhës të dëshmorëve, Drejtues dhe përfaqësues të shoqatave dhe institucioneve të ndryshme.

Mediatizimi: Nuk ka patur media te pranishme.”

Nga verifikimi i rrethanave dhe fakteve, rezultoi se bashkia Përmet nuk është organizatore e aktivitetit të sipër përmendur, për pasojë në referim të legjislacionit në fuqi, detyrimi për raportimin e aktivitetit nuk i atribuohet Shoqata e Veteranëve, Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve.

Ky detyrim është për institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, të cilat duhet të raportojnë në Komisionin Qendror të zgjedhjeve të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Përmet, nuk përbën shkelje të nenit 92, Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj zj. Denisa Durro, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në bashkinë Përmet.
2. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI